



Nr. 5 Prot.

Tiranë, më 15.01.2020

## KËRKESË

**KËRKUES:** **PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË**, në cilësinë e kallëzuesit të veprës penale, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i PDSH-së **Gazment Bardhi**, me adresë njoftimi “Bulevardi “Zhan D’Ark, Nr. 11, Tiranë”

**DREJTUAR:** **PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DIBËR**  
**PROKURORISË SË PËRGJITHSHME**

**NË VËMENDJE:** **AMBASADËS SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, TIRANË**  
**DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EUROPIAN, TIRANË**  
**TË GJITHA AMBASADAVE TË VENDEVE ANËTARE TË BE, TIRANË**  
**PREZENCËS SË OSBE, TIRANË**  
**ZYRËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS, TIRANË**

**LËNDA:** Kërkesë për informacion në lidhje me procedimin penal nr. 184/2016

**BAZA LIGJORE:** Nenet 110 dhe 327 e vijues të të K.Pr.Penale

Në Shtator 2016, Partia Demokratike e Shqipërisë, ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda një kallëzim penal për veprat penale “dhënie e shpërblimeve dhe premtimeve”, “kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, “grup i strukturuar kriminal”, dhe “kryerja e veprave penale nga organizatat kriminale dhe grupi strukturuar kriminal”, të parashikuar nga nenet 328, 329, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

Në bazë të këtij kallëzimi është regjistruar procedimi penal **nr. 184/viti 2016**. Në kallëzim evidentohen faktet sesi funksionarë të lartë publik, përfshirë Kryeministrin, ministra, deputetë, Shefin e komisariatit të polisë së Dibrës, drejtorin rajonal të arsimit, drejtorin e OSHEE-së për veriun, etj., kanë kanë krijuar një grup të strukturuar kriminal për të kryer krimin e blerjes së votave dhe shantazhimit ndaj votuesve, nëpërmjet përdorimit edhe të eksponentëve të krimit të organizuar.

Kjo dosje hetimore është e një rëndësie jetike për demokracinë funksionale në Shqipëri, duke qenë se prek themelin e një shteti demokratik, që janë zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Nga ana tjetër, ndëshkimi i krimeve elektorale është një nga kushtet kyçë të vendosura nga Bundestagu për hapjen e negociatave me Bashkinin European nga Shqipëria.

Mirëpo, për fakt të keq, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, e kishte lënë këtë dosje në harresë, duke mos ushtruar detyrën e vet kushtetuese për vënien përpara përgjegjësisë penale të personave përgjegjës, përfshirë deputetët Damian Gjiknuri, Ulsi Manja, Xhemal Qefaliaj apo Pjerin Ndreu. Për këtë shkak, të paktën katër persona të përfshirë direkt në krime zgjedhore, sipas përgjimeve të bëra publike të dosjes nr. 184/2016 apo provave të depozituar me kallëzimin penal, në vend që të përballeshin me akuza penale, u graduan nga

Kreu i Grupit të Strukturuar Kriminal Edi Rama, si kandidatë dhe më pas u emëruan prej tij si Kryebashkiakë nga votimet mioniste antikushtetuese të 30 Qershorit. Konkrektisht, i referohemi personave të kallëzuar dhe pjesë e dosjes hetimore, si: Pjerin Ndreu (Lezhë), Valbona Sako (Durrës), Dionis Imeraj (Dibër) apo Agron Malaj (Mat).

Më shkresën nr. 32 Prot., datë 07.03.2019, Partia Demokratike e Shqipërisë, për shkak se kishte kaluar një kohë e gjatë nga momenti i depozitimit të kallëzimit penal, kërkoi pranë Prokurorisë për Krime të Rënda “informacion në lidhje me gjendjen e procedimit penal nr. 184/2016, si dhe njohjen me provat dhe aktet e administruara për këtë procedim deri në atë moment”.

Në përgjigje të kësaj kërkese, Prokuroria pranë Gjykatës së Shakllës së Parë për Krime të Rënda, me shkresën nr. 2423 Prot., datë 21.03.2019, në mënyrë të përbledhur na informonte se:

1. Prokuroria e Krimeve të Renda ka regjistruar procedimin penal nr. 184, viti 2016, për veprat penale “dhënie e shpërblimeve dhe premtimeve”, “kanosja ao dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, “grup i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 328, 329 dhe 333/a të Kodit penal.
2. Në kohën kur kanë qenë duke u zhvilluar zgjedhje të pjesëshme vendore për Kryetar të Bashkisë Dibër, janë kryer një sërë përgjimesh të bisedave dhe komunikimeve telefonike, ndaj disa personave të ndryshëm, dhe se veprimet e përgjimit nuk kanë qenë të shoqëruara me veprime hetimore të tjera.
3. Për këtë çështje janë ngarkuar në periudha të ndryshme katër prokurorë të ndryshëm.
4. Në muajn Mars 2019, grapi i ri hetimor, kishte urdhëruar veprime “intensive” hetimore, duke përfshirë edhe transkriptimin e plotë të gjitha bisedave dhe komunikimeve telefomrike të përgjuara, të cilat më parë ishin kryer në mënyrë të pjesëshme. Hetimet ishin në zhvillim e sipër dhe se ende nuk kishin përfunduar.

Në Qershor 2019, gazeta prestigjoze gjermane BILD publikoi disa përgjime, pjesë të kësaj dosje hetimore, ku provohej qartë, jo vetëm veprimitaria kriminale për vjedhjen e zgjedhjeve vendore në Dibër, por edhe fakti se kjo veprimitari ishte e strukturuar, në kuadër të një grapi të strukturuar kriminal, që drejtohej personalisht nga Edi Rama, Kryeministër i Shqipërisë dhe Damian Gjiknuri, deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Në kushtet kur i gjithë opinioni publik priste veprimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për të vënë përpara përgjegjësisë cilido që kishte shkelur ligjin, në mënyrë të papritur dhe krejtësisht jo transparente, në kulmin e krizës politike dhe debatit publik për votimet e 30 Qershorit 2019, informohemi se me vendimin e datës 15.07.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka shpallur moskompetencën për këtë procedim penal, duke kaluar aktet në Prokurorinë pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Dibër. Për këtë jemi informuar nëpërmjet medias dhe më pas nëpërmjet një njoftimi zyrtar të Prokurorisë së Përgjithshëm.

Në kallëzimin e depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, që u provua si tërësisht i vërtetë edhe nga disa përgjime të bëra publike në media në muajin Qershor 2019, është argumentuar ligjërisht, me fakte e prova, se në rastin konkret jemi përpara një “grupi të strukturuar kriminal” dhe se jemi përpara veprave penale të konsumuara nga subjekte të posaçme që janë subjekte të Prokurorisë së Posacme Kundër krimit dhe korruptionit (SPAK). Çështje të tjera penale, siç është dosje hetimore nr. 339/1/2017, forcojnë edhe më shumë dyshimin e arsyeshëm se jemi përpara një grapi të strukturuar kriminal, që nuk është krijuar rastësisht, por është krijuar me qëllimin e vetëm të vjedhjes së zgjedhjeve dhe përfituar pushtetin nëpërmjet krimeve elektorale dhe bashkëpunimit me krimin e organizuar; që nuk vepron në mënyrë të izoluar vetëm në Dibër, por

ka shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që përsërit krimet sa herë ka zgjedhje në Shqipëri (2015, 2016, 2017 dhe votimeve antikushtetuese të 2019). Ashtu sikurse përgjimet e publikuara nga BILD provuan se në krye të këtij “grupi të strukturuar kriminal” qëndron Edi Rama, Kryeministri i Shqipërisë, dhe Damian Gjiknuri, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, që i cakton objektiva anëtarëve dhe më pas kontrollon realizimin e objektivave prej tyre.

Sot pas 6 muajve që kjo dosje hetimore ka kaluar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, nuk ka asnjë informacion se çfarë ecurie ka ky hetim, çfarë veprimesh janë kryer me dosjen dhe në çfarë faze janë hetimet. Ne shprehim indinjatën tonë të thellë për mungesën e veprimit nga ana e organit të prokurorisë dhe veprimeve të kryera me këtë dosje, që po siguron pandëshkushmérinë reale të krimeve elektorale, duke nxitur përsëritjen e tyre sa herë ka zgjedhje në Shqipëri.

Nisur nga fakti që pjesë e kësaj dosje hetimore janë zyrtarë të lartë të Qeverisë, përfshirë Kryeministrin Edi Rama, ish-Ministrin dhe deputetin Damian Gjiknuri, kandidati i Partisë Socialiste për Bashkinë Lezhë Pjerin Ndreu, Kryetari i Komisionit Parlamentar të Ligjeve Ulsi Manja, kandidati i Partisë Socialiste për Bashkinë Dibër Dionis Imeraj, kandidati i Partisë Socialiste për Bashkinë Mat Agron Malaj, etj, në përputhje me nenin 148/dh të Kushtetutës, hetimi i kesaj çështje është kompetencë e Prokurorisë së Posaçme.

Duke qenë se në cilësinë e kallëzuesit nuk kemi asnjë informacion në lidhje me gjendjen e këtij procedimi penal, dhe bazuar në faktin se edhe pse kanë kaluar më shumë se 3 vjet, prokuroria nuk ka konkluduar mbi këtë çështje penale, duke mos kryer/përfunduar hetimet e nevojshme sipas ligjit dhe vënien përpara përgjegjësisë penale të autorëve, **Në mbështetje të nenit 110 të K.Pr.Penale, ku parashikohet se: “Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim”,** kërkojmë:

- 1- Informacion në lidhje me gjendjen e procedimit penal nr. 184/2016;
- 2- Informacion nëse Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër ka shpallur apo jo moskompetencën dhe a i janë kaluar aktet Prokurorisë së Posaçme, si dhe
- 3- Në përputhje me të drejtën që na njeh ligji, të njihem me provat dhe aktet e administruara për këtë procedim deri në këtë moment.

Mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj sipas ligjit.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM  
GAZMENT BARDHI

